



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 29 korrik 2019, në mbledhjen e XXII (njëzetedy) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediave, një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të propozuar të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 26.07.2019, dhe shtoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse nuk ka e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar dhe konstatimeve nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas materialit të dërguar dhe konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 korrik 2019.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 28 qershor 2019

z.Fitim Haziri, kërkoj që në disa raste, në diskutimin e tij ku është shkruar fjala “mundësi” të korrigjohet përkatësisht duhet të jetë “Mendësi”

Njëzëri, me korrigjimin e cekur nga parafolësi, u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më 28 qershor 2019

2. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për Komunën e Podujevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018

➤ Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, të nderuar të pranishëm, gjatë periudhës së parë të këtij viti, Komunën e Podujevës e audituar një ekip i Zyrës Kombëtare të Auditimit – ZKA, i cili për qëllim ka pasur auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31.12.2018, dhe ku janë përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet e kryera të Komunës gjatë vitit 2018.

Bashkëpunimi ynë si Komunë me zyrtarët e ZKA-së ka qenë korrekt për të gjitha çështjet që kanë qenë objekt i auditimit për çka edhe jemi vlerësuar nga ana e tyre.

Auditimi ka qenë i fokusuar sa i përket pasqyrave vjetore financiare, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e viti paraprak dhe viteve tjera të mëparshme.

Opinionet e auditimit mund të jenë të ndryshme varësisht nga të gjeturat, por çdo herë të bazuara në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, të cilat janë; -mohim i opinionit, -opinion i kundërt, -opinion i modifikuar, dhe -opinion i pamodifikuar, e që sqarimet për secilin nga këto, auditori i jep në faqet 38 dhe 39 të raportit.

Ashtu siç e keni parë të gjithë në materialin e dërguar, për Komunën e Podujevës, ZKA ka dhënë opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes, sipas të cilit ndër të tjera pasqyrat vjetore financiare prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet material të pranimeve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31.12.2018, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për shërbimet publike (të kontabilitetit në para të gatshme, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit dhe rregulloren financiare për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Financave).

Natyrisht një opinion i pamodifikuar jepet atëherë kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale, siç janë;

1-Pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente - të qëndrueshme.

2-Pasqyrat janë në pajtim me kërkesat, standardet dhe rregulloret në fuqi;

3-Pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohurit e auditorit në lidhje me entitetin e audituar.

4-Pasqyrat paraqesin një shpalosje adekuate të të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

Ndërsa theksimi i çështjes, sipas auditorit ka ndodhur për defekte sa i përket pasurisë kapitale ku janë konstatuar disa gabime të cilat kanë rezultuar te saktësia e të hyrave dhe të dhënat për pasqyrat financiare.

Konkluzioni i përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit është, citoj

Kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, mirëpo janë vërejtur disa dobësi tek disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë, shpenzimet, të hyrat, pasuritë dhe llogaritë e arkëtueshme.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit tek projektet kapitale ishte realizuar në një vlerë të vogël.

Rekomandimet e vitit paraprak nuk adresohen ashtu siç i përket zhvillimit dhe përmirësimit të organizatës.

Angazhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial që duhet të forcohen.

Lidhur me vërejtjet, gjegjësisht çështjet e ngritura, auditori ka dhënë rekomandime në mënyrë që Kryetari i Komunës së bashku me stafin e vet t'i ndërmerr veprimet e duhura që çështjet në fjalë në të ardhmen të mos përsëriten, dhe duke marrë për bazë ato çështje, ne kemi përgatitur një plan të veprimit lidhur me veprimet e kërkuara nga secili rekomandim i dhënë në raport, në mënyrë që vërejtjet e njëjta mundësisht të mos përsëritësen më në raportet e ardhshme të auditorit, plan i cili i është dërguar ZKA-së dhe është pjese përbërës e këtij materiali që po diskutojmë tani.

Po e përfundoj këtë fjalë hyrëse me rekomandimin se, nëse Komuna gjegjësisht organizata buxhetore merr një opinion të tillë, të pamodifikuar, atëherë tatimpaguesit mund të jenë të kënaqur ngase taksat e tyre janë duke u përdorur në mënyrë korrekte.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit LDK, raportin në fjalë dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, i konsideron si një prej raporteve vjetore që duhet konsiderohen me rëndësi shumë të veçantë duke rikujtuar që krahas raporteve pozitive dhe që paraqesin auditorët e jashtëm ndër vite, Komuna e Podujevës ka arritur të realizoj donacione nga Ministritë dhe nga Organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Duke marrë parasysh që raporti si i tillë paraqet opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes, opinion me të cilin Kryetari i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar që do të zbatoj të gjitha rekomandimet e dhëna, iu mbetet Drejtorive përkatëse të cilat janë atakuar për situatat e përshkruara në këtë raport, të ndërmarrin hapa konkret që veprime të tilla të mos përsëriten më.

Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, edhe në vitin e kaluar kemi rekomanduar që Komuna e Podujevës të ndërton një data-bazë me të dhëna konkrete duke përfshirë edhe pasuritë edhe inventarin që posedon ku përmes softwer-ëve të qasshëm, jo vetëm për auditorin por edhe për qytetarët do të ofronin një mundësi të mirë që të pajisen me këto të dhëna.

Konsiderojmë që Auditori i brendshëm, që vepron brenda Komunës duhet të ofroj në vazhdimësi rekomandime paraprake për Drejtoritë përkatëse si paralajmërues për veprimet e caktuara që lidhen me fushveprimtaritë e Drejtorive. Vlen të theksohet se është për tu përhëndetur themelimi i Komitetit të auditimit, por si komitet, ashtu siç është theksuar edhe në raport që ka pasë vetëm tri takime gjatë vitit, urojmë që ky Komitet të mbledhet sa më shpesh dhe të jap kontributin e tij në funksion të përmirësimit të çështjeve.

Të respektuar të pranishëm, krejt në fund, formula për dal një raport i auditimit pozitiv, është e thjeshtë, mjafton t'iu shërbejmë qytetarëve me ndershmëri, sinqeritet, profesionalizëm, transparencë dhe llogaridhënie.

z.Fitim Haziri, theksoi, njeriu asnjëherë nuk mund të bëjë të njëjtin gabim për të dytën herë sepse herën e dytë nuk është më gabim por është zgjedhje e tij, hera e parë mund të jetë gabim, në herën e dytë është vendim, ndërsa në të tretën herë në të njëjtin gabim është karakteri i tij. Pra siç po shihet është në karakterin e kësaj qeverisje t'i përsërisë të njëjtat gabime ku në çdo raport të zyrës së Auditimit për Komunën e Podujevës thuhet, rekomandimet e vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës, pra nuk ekziston vullneti për qeverisjen e mirë. Gjithashtu raporti i auditimit përsëritë vazhdimisht që një dekadë të njëjtin projekt i cili iu ishte premtuar qytetarëve që banojnë në fshatrat Metehi, Zakut, Dobërdol, Kërpimeh, Pakashticë e Epërme dhe Pakashticë e Poshtme si dhe vetë fshatin Revuç, që do të ketë ujë të pijes, nga kjo po shihet se Komuna ka heqë dorë nga ky projekt edhe pse banorët kanë ndarë mjete dhe janë mashtruar, gjë për të cilën në raport thuhet, qytetarët kishin participuar në vlerë prej 70,120.00€, shumë e cila është duke u bartur vit pas viti për shkak të mos realizimit të projektit, sipas Komunës një prej fshatrave ka krijuar pengesa për shfrytëzimin e burimit të ujit derisa pagesat për punët e kryera në disa fshatra arrin vlerën prej 173,000.00€, çështje kjo e cila është ngritur edhe në vitin e

kaluar ngase është projekt me ndikim social, vonesat e të cilit prekin mirëqenien e qytetarëve të cilët kanë participuar drejtpërdrejt në zbatimin e tij. Pra të nderuar nëse kjo qeverisje komunale vazhdon t'i përsërisë të njëjtat gabime pa pushim, ky vend ka nevojë për një ndryshim, e ndryshimi po dihet. Shqetësues është fakti se ky raport e nxjerrë shumë keq të vetmin ekspert që e ka Komuna e Podujevës, i cili nuk ka arritur të realizoj buxhetin e që në raport thuhet, Komuna kishte buxhetuar 7,012,525.00€ për të investuar në projekte kapitale nga të cilat ka shpenzuar vetëm 68% apo 4,744,046.00€, e që një fjalë e urtë thotë, veprat flasin më bindshëm se fjalët, pra këtu e kam fjalën për ekspertin e vetëm që kemi në Komunë.

Sikurse në vitin 2017 ashtu edhe në vitin 2018 auditori i përgjithshëm ka gjetur shkelje të shumta në ndarjen e subvencioneve nga ana e Komunës së Podujevës, pra kemi gabime të cilat përsëriten vazhdimisht, shkelje të cilat janë gjetur në raportin e auditimit si pasoj e mos respektimit të Rregulloreve të vendosura nga Ministria, ku kemi një keqpërdorim të qëllimtë të subvencioneve dhe që kemi dëmtuar direkt përfituesit potencial, arsyeja juaj se gjoja kjo Rregullore ka filluar së zbatuari në qershorin e vitit të kaluar dhe ende nuk jemi familjarizuar mirë me kërkesat që dalin nga kjo Rregullore, kjo as nuk është e sigurtë nga ana juaj dhe nuk mund të konsiderohet argument. Argument i vetëm që mund të shihet është se ju jeni të prirë për keqpërdorimin e parasë së qytetarëve të Komunës së Podujevës. Ne si LVV edhe më herët kemi propozuar që të përpilohet një Rregullore për ndarjen e subvencioneve në të gjitha fushat.

Shkelje tjetër e cila përsëritet prap në raportin e auditimit është ajo e punësimit të personave me kontrata që iu referohen si, për shërbime të veçanta, ku në raport thuhet, ne kemi testuar 8 raste dhe kemi gjetur që në të gjitha ato raste angazhimi ishte bërë përmes një procedure të thjeshtëzuar të rekrutimit, edhe pse në të gjitha rastet personat e njëjtë ishin angazhuar dhe punonin për kohë më të gjatë se 6 muaj, apo 4 muaj sa është e lejuar me ligj, persona të cilët punonin në pozita të rregullta të punës prej vitesh. Kur jemi tek punësimet auditori potencon se ka pasë shkelje tek kriteret e vendosura për punësim nga Komuna dhe mos respektimi i kriterëve sipas konkursit rritë rrezikun për diskriminim të kandidatëve të cilët mund të jenë më kompetent për atë pozitë, e që ne si LVV vazhdimisht kemi ngritur këto shqetësime dhe kjo qeverisje në shumë raste i ka eliminuar kandidatët më meritore duke iu dhënë përparësi atyre partiak, siç ishte rasti i fundit për vendin e lirë të punës për zyrtar të gjendjes civile, dhe ku është përzgjedh një anëtar i kryesisë së nëndegës së LDK-së në fshatin Letanc.

z.Fatmir Rudari, theksoi, raporti i auditimit për Komunën e Podujevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018, është fokusuar në pasqyrat financiare vjetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe në zbatimin e rekomandimeve.

Theksimi i çështjes, pasuri kapitale nën vlerën 1,000.00€ ishin mbivlerësuar për 171,946.00€ për faktin se këto pasuri ishin regjistruar në sistemin e-pasuria përderisa kishin të bënim me pasuri kapitale mbi 1,000.00€. objekti i hotelit 'Mileniumi 2000' në pronësi të Komunës por i dhënë në shfrytëzim nuk figuron në regjistrin e pasurisë.

Pasuri nën 1,000.00€ ishin paraqitur në pasqyrat financiare vjetore sipas vlerës fillestare duke aplikuar fare zhvlerësimin, ndërsa si çështje kyçe e auditimit edhe në këtë vit është projekti i ndërtimit të ujësjellësit Vrella në bashkëfinancim me qytetar, i cili ka filluar qysh në vitin 2009 dhe i cili ende nuk ka përfunduar, çështje të cilën e kam ngritur edhe në vitin e kaluar e që mendoj se si temë është e konsumuar tani më, por është projekt me ndikim social dhe vonesa e të cilit prek mirëqenien e qytetarëve të cilët kanë participuar drejtpërdrejt në zbatimin e projektit.

Realizimi i buxhetit, Komuna kishte buxhetuar 7,012,525.00€ për të investuar në projekte kapitale nga të cilat ka shpenzuar vetëm 68% apo 4,744,046.00€, ndërsa suficid kishte mbetur 2,268,000.00€, Komuna ka pranuar këtë sfidë për të cilën sipas saj shkaktar janë, vonesa në inicimin dhe lidhjen e

kontratave, vonesa në realizimin e punëve nga kompanitë si dhe mos zgjidhja me kohë e çështjeve pronësore në vendet ku bëhen investime. Për 121 projekte, nga 138 që ishin dashur të kryhen në vitin 2018 tash duhet të shpenzohet buxheti i vitit 2019.

Pagesat përmes vendime Gjyqësore, Komuna ka bërë pagesa të tilla edhe në të kaluarën, ndërsa në vitin 2018 Komuna kishte paguar 28,815.00€, pagesë e cila ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime direkt në llogari të përmbaruesit, ekzekutimi i këtyre pagesave kishte shkaktuar shpenzime shtesë e që vetëm në një pagesë të testuar shpenzimi shtesë ishte në shumë 4,416.00€ e që format e tilla të pagesave përmes vendimeve gjyqësore rrezikojnë realizimin e projekteve dhe që Kryetari i Komunës duhet të ndërmerr masa me kohë në mënyrë që të shmang pagesat e tilla që dëmtojnë buxhetin e qytetarëve.

Mos efikasiteti në mbledhjen e të hyrave, realizimi i të hyrave ishte 71% që tregon një shkallë të ultë krahasuar me planifikimin ambicioz që kishte Komuna, kjo për shkak se Komuna kishte planifikuar të mbledh më shumë të hyra nga taksat për leje të ndërtimit, taksa për regjistrimin e automjeteve, pastaj nga qiraja e objekteve publike, ngarkesat komunale dhe nga certifikatat, dhe një planifikim i tillë ka rezultuar me performancë të dobët në mbledhjen e këtyre të hyrave andaj Kryetari i Komunës duhet të analizoj arsyet e mos inkasimit të të hyrave dhe trendin e të hyrave përgjatë viteve të fundit dhe në bazë të asaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm.

Mos aplikimi i Rregullores për tatimin në pronë, sipas Rregullores në fjalë për vitin 2018, në Komunën e Podujevës është përcaktuar baza e tatimit për 4 zona, ndërsa për 3 nga 7 mostrat e testuara ishin marrë për bazë zona e 3-të kurse sipas rregullores i takonin zonës së 4-të tatimore, më pas thuhet që kemi vërtetuar se Rregullorja në fjalë nuk ishte zbatuar fare, duke bërë që qytetarët të dëmtohen financiarisht, kjo formë ka dëmtuar tatimpaguesit duke krijuar për Komunën të hyra të parregullta. Pastaj ka pasur shkelje edhe sa i përket mungesës së përditësimit të të dhënave, mangësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit ku sipas konkursit për mjek të përgjithshëm në QKMF është kërkuar që kandidatët të kenë 1 vit përvojë pune, kurse kandidati i përzgjedhur në atë pozitë nuk kishte ofruar dëshmi të përvojës së punës, pastaj në konkursin për, zyrtar i të hyrave financiare, është kërkuar që kandidatët të kenë 2 vite përvojë pune profesionale, ndërsa kandidati i përzgjedhur në këtë pozitë sipas aplikacionit nuk kishte përvojën e kërkuar, andaj mos respektimi i kritereve sipas konkursit rritë rrezikun për diskriminimin e kandidatëve të cilët mund të jenë më kompetent për atë pozitë.

Mangësi të kontratat për shërbime të veçanta, Komuna e Podujevës për realizimin e shërbimeve të domosdoshme kishte angazhuar 29 persona me marrëveshje për shërbime të veçanta, dhe në 8 raste të testuara nga auditori, angazhimi ishte bërë përmes procedurave të thjeshtëzuara dhe rekrutimi për të gjitha rastet ishin personat e njëjtë ishin angazhuar dhe punonin në kohë më të gjatë se 6 muaj. Mbulimi i pozitave me marrëveshje për shërbime të veçanta rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasiguri nëse në pozita të tilla është angazhuar stafi meritör.

Vazhdimi i kontratës pa procedura të prokurimit, sipas Rregullores dhe Udhëzuesit të prokurimit publik, një kontratë nuk mund të vazhdohet ose nuk mund të ripërtërihet pa një kontratë pasuese dhe pa administrimin e procedurave.

Komuna e Podujevës në nëntor të vitit 2017 kishte nënshkruar kontratën për furnizim me dru, në vlerë prej 9,575.00€, me kohëzgjatje për 10 ditë.

Anashkalimi i kritereve tek dhënia e subvencioneve, rregullorja 04/2017 lidhur me subvencionet për OJQ-të, neni 16 përcakton kriteret dhe procedurat e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive. Në thirrjen e datës 30.03.2018 Komuna nuk kishte publikuar listën e aplikuesve me pikët e fituara nga secili në bazë të të cilave edhe do të filtronin subvencion por kishte publikuar vetëm listën me emrat e përfituesve,

për më tepër një aplikues kërkesa e të cilit figuronte në librin e protokollit, nuk figuronte fare në listën e aplikuesve, mosrespektimi i rregulloreve të vendosura nga Ministria mund të shpie deri te një keqpërdorim të qëllimshëm të subvencioneve dhe njëkohësisht dëmton direkt përfituesit potencial.

Mangësi tek procedurat për punë shtesë, kontrata është marrëveshje detyimore mes palëve sipas së cilës krijohen detyrime dhe të drejta për palët nënshkruese, para se të fillohet puna apo shërbimi, Komuna kishte lidhur aneks kontratë për projektin e ndërtimit të objektit të SHFMU “Dituria” në vlerë prej 41,113.00€, pas përfundimit të punëve, punët kishin qenë të aprovuara nga menaxheri i kontratës bazuar në çmimet e kontratës bazë, sipas menaxherëve të kontratës punët shtesë ishin të domosdoshme për vazhdimin e projektit, kryerja e punëve shtesë para aneks kontratës mund të ndikoj në kostot shtesë apo të mos merr vlerë për paratë e shpenzuara.

Vonesat në realizimin e projekteve, kontrata për asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Balloc, në vlerë prej 68,966.00€ ishte nënshkruar më datë 20.11.2017 dhe sipas kontratës data e përfundimit të të gjitha punëve do të jetë 25 ditë kalendarike, kontrata në fjalë ka përfunduar në muajin nëntor 2018 ose rreth 1 vit me vonesë. Pastaj kontrata për blerjen e dy ambulancave për bartjen e pacientëve me hemodializë në vlerë prej 59,900.00€ ishte nënshkruar më datë 26.09.2018 dhe sipas kontratës afati i liferimit ishte 45 ditë kalendarike, liferimi është bërë më 28.01.2019 ose me 78 ditë vonesë, nga operatori ekonomik. Mos realizimi i projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratave dhe fillimi i punimeve pa u zgjedhur problemet pronësore ndikojnë në tejzgjatjen e realizimit të projekteve. Ndarja e tenderëve dhe përdorimi i procedurave minimale, menaxhimi jo i mirë i pasurisë, mos raportimi i obligimeve, dobësi në kontrollet menaxheriale, pra këto ishin disa nga të gjeturat e auditorit për vitin 2018.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, propozimet të cilat Grupi i këshilltarëve të LVV-së vazhdimisht i ka paraqitur para Kuvendit dhe vazhdimisht ka bërë paralajmërime për rezultatet e dëmshme që do të korrim, propozime të cilat ju vazhdimisht i keni injoruar pikërisht pse kanë ardhur nga një grup opozitar dhe tani i gjeni të gjitha në raportin e auditorit, dhe në mënyrë kronologjike po i paraqes disa nga ato: -dështimet në përpilimin e raporteve financiare, -dështimet në realizimet e projekteve në kohë dhe lidhjet me kontrata, ku si pasojë vjen ekzekutimi i ulët i realizimit të buxhetit dhe kjo është vlerësuar shumë ulët në raportin e auditorit, -dështim në të hyrat vetanake me theks të veçantë tatimi në pronë ku madje shumë qytetarë edhe janë diskriminuar gjë për të cilën LVV ka shprehur vazhdimisht shqetësim, -shfrytëzimi i pronave të paluajtshme pa pagesë, -punësimi i personave jo të përshtatshëm për kërkesat e vendit të punës, -shkelje të qarta në subvencione të cilat nuk ndahen në përputhje me kriteret.

Çka është me e dhimbshme që si pasojë e mungesës së profesionalizmit keni bërë shpenzime përmbartimore me ç’rast keni dëmtuar buxhetin e Komunës, si dhe shumë e shumë shkelje të tjera të gjetura që janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për të kuptuar që ju nuk jeni të denjë për qeverisje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e mbyllim këtë pikë të rendit të ditës duke shpresuar që raportet tjera të sjellën edhe më pozitive.

3. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2019

z.Isuf Latifi, Drejtor i – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth raportit në fjalë, ndër të tjera theksoi, ky raport ka për qëllim prezantimin e aktiviteteve financiare përgjatë kësaj periudhe, me theks të veçantë shpenzimet e bëra në nivel komunal sipas kategorive dhe sipas burimeve të financimit si dhe duke bërë një krahasim të të gjitha shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit 2018.

Shpenzimet buxhetore për këtë periudhë kanë arritur shumën prej 7,737,976.00€, dhe atë, paga dhe mëditje 5,960,798.00€, mallra dhe shërbime 553,603.00€, shpenzime komunale 262,660.00€, subvencione 83,330.00€, investime kapitale 978,585.00€, e që shprehur në përqindje është 35% e buxhetit të planifikuar, apo shpenzime në kuadër të planifikimit për këtë periudhë kohore dhe nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2018 vërehet një rritje e shpenzimeve prej 5%.

Vlen të theksohet se në këtë vit ka një zvogëlim të shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime dhe kemi një rritje të lehtë të investimet kapitale si dhe në disa kategori tjera, mirëpo kjo nuk do të thotë se jemi të kënaqur me këto shpenzime të kapitalet, absolut jo sepse kjo është një tregues jo i mirë për këtë periudhë raportuese por shpresojmë shumë që në përdhën tjetër të vitit ky trend të përmirësohet.

Sa i përket realizimit dhe planifikimit të të hyrave vetanake për këtë periudhë që janë paraqitur në tabelën e të hyrave e që është 655,153.00€ ose 41% e planit vjetor dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një rritje të të hyrave prej 11% e cila theksohet të tatimi në pronë, taksa për leje ndërtimi, si dhe të hyrat nga qiraja. Edhe pse kjo paraqet një trend pozitiv, ne duhet të angazhohemi shumë më shumë që realizimi i të hyrave të jetë gjithëherë më i lartë.

Karakteristikë kryesore e këtij raporti është se të hyrat janë rritë 11% kurse shpenzimet për 5% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Për fund mund të konstatojmë se është një raport i cili jep një pasqyrë të qartë aktivitetëve financiare për periudhën raportuese.

znj.Valbone Kadriu – Podvorica, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së paraqesë pikëpamjet e grupit lidhur me raportin financiar janar-qershor 2019. Ashtu siç e prezantoj edhe Drejtori parafolës aktivitetet financiare të komunës për këtë gjashtëmuor të vitit, por edhe ashtu siç shihen në raport shpenzimet janë 7,737,976.00€, apo rreth 36% e planit, ku pjesa dërmuese janë për paga dhe mëditje e që është diçka normale, mirëpo kur jemi të shpenzimet vlen të ceket se në kategorinë mallra dhe shërbime ka një zvogëlim të shpenzimeve apo të themi zvogëlim, ku shpenzime telefonike kemi një rënie prej 47% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pastaj vërehen kursime edhe sa i përket furnizime për zyrë, mandej edhe tek riparimi dhe mirëmbajtja e veturave ku është një zvogëlim afër 56%.

Sa i përket investimeve kapitale, shuma prej 978,585.00€, në parim nuk është një shumë e kënaqshme që është shpenzuar por ka rritje në krahasim me vitin e kaluar, siç janë ndërtimi i rrugëve lokale, rregullimi i lumenjve etj, mirëpo mbetemi me shpresë që shpenzimet për investime kapitale të shënojnë rritje në periudhat e ardhshme raportuese.

Sa i përket të hyrave vetanake që paraqesin burimet kryesore të financimit të buxhetit komunal për këtë periudhë raportuese, sipas raportit janë inkasuar 41% e planifikimit e që është një rritje prej 11% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, rritje kjo e cila është të llojet kryesore të të hyrave siç janë tatimi në pronë, të hyrat nga qiraja, të hyrat nga lejet e ndërtimit etj.

Pra mund të themi se ky raport jep një pasqyrë të qartë të të hyrave dhe të dalave për periudhën raportuese.

znj.Doruntina Hasani, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, ky raport financiar për janar – qershor 2019 është tejet joprofesional dhe i vërteton fjalët e keq menaxhimit dhe keq përdorimit të buxhetit të qytetarëve të Komunës së Podujevës, taksat e të cilëve po vazhdojnë të keq menaxhohen çdo ditë, 6,701,304.00€ sa ishin të planifikuara të investoheshin në investime kapitale gjatë vitit 2019, për këto gjashtë muaj janë investuar vetëm 978,585.00€ apo vetëm 14% e që besoj se kjo është një pasqyrë e lartë dhe po paraqitet rreziku i tepërcave buxhetore që të dyfishohen sikurse në vitin e kaluar. Te mallrat dhe shërbimet, edhe pse në vitin 2019 ka në planifikim 254,000.00€ më shumë se në vitin 2018, trendi i shpenzimeve në këtë sektor nga 2,178,773.00€ janë shpenzuar vetëm 553,603.00€ apo vetëm 25%, pjesë e cila tregon keq menaxhim sepse të gjithë e dimë sa vuajnë për

mallra dhe shërbime institucionet arsimore dhe ato shëndetësore, me theks për materiale higjienike, përse të shpenzohen vetëm 25% kur jemi në dijeni se nëpër shkolla gjysmë vjetori i dytë është më shkurtër për shkak të pushimit verorë. Te subvencionet në vend që të ketë rritje të buxhetit në këtë sektor, ai është zvogëluar për 41,117.00€ në krahasim me vitin 2018 kurse deri tani janë shpenzuar vetëm 82,330.00€ apo vetëm 13% nga 610,000.00€ sa janë në përgjithësi. Gjatë këtyre gjashtë muajve vërehet se nuk është investuar në asnjë objekt sportiv dhe nuk është bërë asgjë për bibliotekën e qytetit edhe pse qëndron e mbyllur që një vit, dhe pavarësisht mjerimit social, ekonomik dhe arsimor buxheti nuk orientohet aty ku nevojat janë më të mëdha por vetëm aty ku është forma më e lehtë për tu keqpërdorë. Po të hyjmë nëpër Drejtori veç e veç, Drejtoria e urbanizmit dhe e shërbimeve publike nga buxheti i planifikuar për këtë Drejtori mbi 5 milion euro, janë shpenzuar rreth 700,000.00€ apo vetëm 13% e që i njëjti drejtor i cili e ka cilësuar vetën ekspert në mbledhjen e kaluar, i ka tepruar buxhet rreth 1 milion euro në vitin e kaluar, kurse në këtë vit sipas këtij raporti pritet dyfishimi i kësaj shume. Këtë vit paksa më mirë qëndron Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale sa i përket realizimit të investimeve kapitale e kjo duhet të jetë si rezultat i kritikave tona që kemi dhënë nga viti i kaluar e që rezulton me përqindjen më të ulët nga të gjitha Drejtoritë. Tek vendimet Gjyqësore janë 41,809.00€ të shpenzuara, dhe pse ne si Komunë po jemi të detyruar të paguajmë një shumë aq të madhe për vendime Gjyqësore.

Sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake kemi një rritje të vogël mirëpo problemi qëndron te tatimi në pronë dhe mos regjistrimi i pronave e që besoj se kjo gjë është shumë e mundshme ngase në raportin e kaluar të auditimit ka qenë vërejtje se afro 18 mijë prona nuk janë të tatimuara, besoj se kjo do të përfundojë lehtë duke i krahasuar pronat me njezësorët elektrik në Komunën e Podujevës.

Ne shprehim shqetësimin tonë lidhur me shpenzimin e parasë publike nga ana e ekzekutivit të kësaj Komune dhe mendoj se si të përzgjedhur të qytetarëve që jemi duhet të bëhemi bashkë, të mos e mbështesim keqmenaxhimin me vetëm 14% investime kapitale për gjashtëmujorin e parë të vitit.

Për fund mund të themi se kjo qeverisje është në gjendje alarmante dhe pritet dyfishim i tepicës së buxhetit, ishin 2 milion, kurse paramendojeni sa mund të jenë.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, theksoi, raporti financiar për periudhën janar – qershor 2019 prezanton një pasqyrë për aktivitetet financiare të zhvilluara gjatë gjashtëmujori të parë të vitit. Buxheti i komunës i miratuar për vitin 2019 është 22,032,619.00€.

Në këtë gjashtëmujor Komuna ka inkasuar të hyra vetanake 854,809.00€ deri sa në tremujorin e parë kishte inkasuar 527,191.00€. Te shfrytëzimi i pronës komunale në tremujorin e parë të vitit janë inkasuar 25,533.00€ kurse në tremujorin e dytë ka inkasuar vetëm 6,154.00€ e që ndoshta Drejtoria do të jap sqarime më shumë për këtë çështje.

Shqetësim tjetër është realizimi i shpenzimeve kapitale, vlera e planifikuar për shpenzime kapitale për këtë vit është 6,701,304.00€, kurse për këtë periudhë raportuese janë shpenzuar 978,585.00€ apo vetëm 14.6% e totalit, ndërsa në tremujorin e parë të vitit ishin shpenzuar 219,658.00€ apo rreth 3.2%, andaj nëse qeverisja aktuale vazhdon me këtë trend të realizimit të projekteve kapitale, fatkeqësisht do të na përsëritet viti 2018 ku vetëm 68% të planifikimit për investime kapitale janë realizuar. Ne mendojmë se Komuna e Podujevës ka aq shumë nevojë për investime kapitale sa që këto planifikime do të duhej të realizoheshin në tërësi.

Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal është planifikuar në mënyrë jo të mirë, taksa komunale janë planifikuar 828,175.00€ ndërsa janë realizuar 292,648.00€, licencat dhe lejet janë planifikuar 200,000.00€ kurse janë realizuar 21,664.00€, për leje për ndërtesa janë planifikuar 230,000.00€ kurse janë realizuar 48,200.00€, që do të thotë se është bërë një planifikim jo i mirë nga ana e qeverisjes aktuale.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, atëherë e mbyllim këtë pikët të rendit të ditës duke kërkuar ne si Kuvend që shpenzimet të jenë më të larta në gjysmën e dytë të vitit.

4. Propozim Programi Trevjeçar i Banimit 2019 – 2021

➤ Raporti nga diskutimi/debati publik lidhur me programin trevjeçar të banimit 2019/2021

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth Programit trevjeçar të banimit 2019/2021 në Komunën e Podujevës, respektivisht raportin nga diskutimi dhe debati publik, ndër të tjera theksoi, para vetës keni Programin trevjeçar të banimit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës i cili është vazhdimësi e një projekti për të cilin edhe kemi diskutuar sa ka qenë si draft. Jeni në dijeni se ky dokument i është nënshtruar një diskutimi dhe debati publik me qytetarë ku kohëzgjatja ka qenë 30 ditë, pastaj është mbajtur edhe debati publik me qytetarë më 29 maj 2019. Jemi munduar të hartojmë një program sa më të kompletuar i cili ka të bëjë me kategori të caktuara dhe është një dokument i cili do të implementohet në vitet në vijim andaj edhe sot presim propozime, sugjerime dhe plotësim ndryshime nga ana juaj.

Natyrisht në raportin që është pjesë e programit, keni mund të vëreni edhe propozimet dhe rekomandimet e bëra gjatë diskutimeve dhe debateve publike me qytetarë. Nga ju pres ta mbështetni këtë program i cili të paktën është një nismë e mirë që përcaktohen kufijtë e qartë, si dhe është një program më i mirë i mundshëm.

znj.Liridiona Shabani, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, e përkrahim këtë dokument – program trevjeçar të banimit 2019-2021, i cili është i hartuar nga ekspert vendorë dhe të jashtëm dhe i cili ka për qëllim zgjidhjen racionale të banimit social. Jemi të vetëdijshëm se zgjidhja e banimit social është një çështje mjaft komplekse dhe si e tillë kërkon vëmendje të veçantë, andaj ne e përkrahim dhe jemi të gatshëm të japim kontribute në këtë fushë, duke marrë parasysh se në këtë dokument është bërë një analizë e gjendjes aktuale dhe janë identifikuar problemet e mundshme përmes një analize Swot. Financimi i programeve të veçanta të banimit mbetet sfidë jo vetëm e Komunës tonë por edhe për komunat tjera, edhe përkundër faktit se Komuna e Podujevës gjithëherë ka ndarë mjete për ndërtimin e shtëpive për njerëzit në nevojë. Për fund kërkoj të mbështete ky program si dhe nga Drejtorët e Drejtorive përgjegjëse kërkoj realizimin e tij.

z.Vendenis Lahu, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, rreth propozim Programit trevjeçar të banimit 2019 – 2021 ne si grup i kemi dhënë vërejtjet dhe propozimet tona në mbledhjet e kaluara, sa kemi parë nuk janë marrë parasysh, megjithatë është mbajtur një debat me qytetarë prej të cilit kanë rrjedh disa rekomandime dhe është mbajtur një diskutim publik i cili sa duket më shumë ka qenë formal se sa përmbajtësorë, e them këtë ngase në diskutimet kanë rrjedh disa rekomandime, si; vazhdim i bashkëpunimit me donatorë, identifikim i familjeve në nevojë, çështje të cilat mendoj se janë të vetëkuptueshme, andaj edhe e thash që diskutimi ka qenë më shumë formal se sa përmbajtësorë. Në terren kemi parë se gjendja është e keqe dhe ky program nuk do ta zgjidh atë gjendje. Konstatojmë se nuk i është dhënë vëmendje e duhur problemit të banimit dhe rrjedhimisht gjendja do të vazhdoj të jetë e tillë siç është por jo e mirë.

z.Fatmir Rudari, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, para se ky dokument të vëhet në diskutim publik e kam dhënë një sugjerim, dhe atë tek pika, *-banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët, të cilat jepen me qira*. Këtu në dokument thuhet se Komuna e Podujevës për momentin nuk ka banesa të ndërtuara nga Komuna, Qeveria apo nga Donatorët që do të jepen me qira, por

planifikon që shtëpitë e ndërtuara në Lagjen e Dëshmorëve, t'iu caktohet një vlerë e qirasë për shfrytëzimin e tyre.

Pra për këtë çështje ka dhënë vërejtje edhe në diskutimin e parë për këtë program, dhe tani vërejta se nuk është marrë parasysh dhe nuk është përmirësuar. E që dua të them se ne nuk pajtohemi që atyre shtëpive të ndërtuara në atë lagje t'iu vëhet vlerë e qirasë sepse mendojmë se ka raste sociale shumë në atë Lagje dhe nuk kanë mundësi ta paguajnë atë qira.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, sa i përket DSHMS dhe Komunës së Podujevës në përgjithësi, rreth zgjidhjes së çështjes së banimit për qytetarët në nevojë, ekskluzivisht kategorive të caktuara që janë të përshkruara edhe në Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit, por edhe punët e përditshme që janë si aktivitete në kuadër të Drejtorisë.

Komuna e Podujevës këtë vit ka filluar ndërtimin edhe të 20 shtëpive të reja, si vazhdimësi e projektit për ndërtimin e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, e që me përfundimin e tyre Komunën e Podujevës do ta gjejë me 90 shtëpi të ndërtuara për kategoritë e caktuara, në fakt për kategoritë të cilat janë duke jetuar aktualisht në Lagjen e Dëshmorëve, por që sfidë na mbetet viti i ardhshëm.

Unë mendoj që bashkëpunimi që ekziston mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes një Memorandumi të Bashkëpunimit, ku viteve të fundit ndahen mjete financiare për ndërtimin e shtëpive në atë Lagje dhe besoj se edhe për vitin e ardhshëm 2020 do të ketë vazhdimësi të ndarjes së buxhetit qoftë nga Ministria qoftë nga Komuna dhe do përfundoj i tëri ky projekt, e që natyrisht se të gjithë jemi të interesuar t'iu ndihmojmë njerëzve në nevojë, sidomos atyre në Lagjen e cekur, mirëpo sa i përket çështjes së qirasë, e di se është e ndjeshme për atë kategori mirëpo parashihet në Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit, ndërsa nga ne si komunë, pritet që sa do ta përcaktojmë atë vlerë të qirasë, ndoshta mund të jetë vetëm 1€, por që ata qytetarët duhet të njoftohen se ato objekte – shtëpi banimi janë të ndërtuara për ofrimin e zgjidhjes së përkohshme për ato familje në nevojë dhe që kanë status përkatës, por që në momentin që ata qytetarë nxjerrën nga ai status social unë mendoj se duhet dhe do të paraqiten ndoshta qytetarë tjerë që do të kenë nevojë për strehim. Absolutisht që ne jemi të kënaqur që atyre banorëve ju kemi bërë zgjidhje me shtëpi banimi të cilat ka raste që edhe i kanë rrenovuar, dhe jemi në dijeni se deri në një masë ata qytetarë e kanë rregulluar statusin e vetë social, mirëpo qiraja nuk është çështje që ne e përcaktojmë por vetëm duhet të zbatojmë ligjin.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kam informata rreth familjeve që banojnë në Lagjen e Dëshmorëve, janë dy kategori që banojnë në atë Lagje, njëra është kategori e luftës të cilët edhe zyrtarisht janë të liruar nga çdo lloj i tatimit, dhe tjetra kategori është sociale të cilët po ashtu besoj se janë të liruar nga tatimet, andaj nuk e kuptoj se si mund t'i vëhet një taksë atyre 2 kategorive sepse janë të liruar edhe me ligjet në fuqi, për këtë arsye edhe parashtrova pyetje se për çfarë qiraje bëhet fjalë, por meqë drejtori parafolës e tha se mund të jetë 1 €, më duket se mund të jetë e arsyeshme.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, mendoj se të gjithë ne si organe komunale duhet që në vazhdimësi të përcaktojmë kritere për atë lokacion i cili përfshinë shtëpi banimi si skemë e veçantë e banimit për kategori të caktuara. Ne sot kemi informata që në atë Lagje ka familje që i takojnë një kategorie që parafolësi e përmendi, e që absolut të gjithë kemi respekt për kategori të tilla, por që ka dal përfitues i shtëpisë në bazë të kritereve të përcaktuara dhe sot rrinë e mbyllur ajo shtëpi, ndërsa në anën tjetër ne si DSHMS kemi shumë raste tjera të rënda të cilat kanë probleme sa i përket zgjidhjes së çështjes së banimit. Ndoshta nga këtu duhet të rrjedh një iniciativë për formimin e një Komisioni me të cilin do të përcaktonim kriterin se është e nevojshme apo jo të bëhet një rivlerësim që për një kategori të caktuar, në një situatë të caktuar dhe për një kohë të caktuar ka qenë një familje përfituese e shtëpisë, ndoshta është mirë të bëhet edhe rivlerësim, andaj në të ardhmen nëse ju mendoni se një gjë e tillë është e nevojshme mund të ndërmarim veprime. Prandaj edhe njëherë e

përsëris që kemi shtëpi të cilat rrinë të mbyllura, nuk shfrytëzohen por që iu ka takuar në bazë të kriterëve, por që sot rrinë e pashfrytëzuar, e që në një formë mund të llogaritet si një lloj uzurpimi, ndërsa në anën tjetër kemi shumë familje të cilat jetojnë në kushte të rënda dhe që nuk kemi mundësi t'i bëjmë zgjidhje të banimit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, meqë pothuajse të gjitha subjektet kanë anëtarët e tyre në komisionin për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, unë po mendoj se ndoshta u stërgjatat paksa diskutimi rreth programit trevjeçar të banimit vetëm për atë Lagjen e Dëshmorëve, meqë është projekt ende i papërfunduar e që sa jam i informuar nuk janë filluar punimet ende për shkak të mos lirimit të hapësirave dhe pastrimit nga mbetjet e kontejnerëve që kanë qenë.

Shtroj pyetje, mbi bazën e cilit kriter bëhet ndarja e shtëpive, sa jam në dijeni unë ajo ndarje bëhet mbi bazën e dy kriterëve, 1-kriteri social, ku një familje mund të mos ketë kushte për mbijetesë, si dhe 2-kriteri, (në bazë të shoqatave të dala nga lufta) sipas të cilit përfitojnë njerëzit luftëtarë të cilët ose janë të plaguar apo janë veteran të cilët kanë një kategori më të ulët të jetesës, pra mbi këto dy kriterë bëhet ndarja e shtëpive në atë lagje, dhe tani nëse ky program fillon këtë vit dhe që është i planifikuar edhe për 2 vitet e ardhshme, është e palogjikshme të vendoset taksë, madje madje si do të taksohen ata që janë duke jetuar në kontejner. Pra a do të zbatohet taksa në vitin 2019 ose në vitin 2020, pyetje kjo sepse ky program është i propozuar nga DSHMS e që sa po shoh unë edhe vet Drejtori nuk po është në dijeni me procedura dhe kompetencat që i ka, dhe të cilin po e pyes se a planifikon vënien e taksës në vitin 2019 ose 2020, nëse po ne duhet ta dimë se ku mblidhen dhe sa është vlera e taksës. Pra Drejtoria duhet të përcaktoj shumën e jo ne si këshilltarë sepse ne nuk qeverisim, pra në plan duhet të caktohet shumën e qirasë për këtë trevjeçar, gjithnjë duke u bazuar në ligj. Prandaj pyetja konkrete ishte, kur do të filloj taksa në Lagjen e Dëshmorëve, kush do të taksohet, sa është vlera e qirasë dhe për cilat kategori, sepse ne nuk mund të vendosim hipotetikisht, kurse ti pastaj si drejtor të vësh taksën qoftë për Lagjen e Dëshmorëve po edhe për banesat tjera.

E bëra këtë pyetje sepse programi ose duhet të votohet ose të kundërshtohet dhe se është në interes të të gjithë këshilltarëve, por siç po duket këtë çështje e keni të paqartë edhe ju Drejtor.

Presim përgjigje sepse kemi me votuar por që nuk po jemi të kjashtë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni kush dëshiron të marrë fjalën, nëse nuk ka e hedh në këtë pikët të rendit të ditës, përkatësisht Programin trevjeçar të banimit 2019 – 2020 sipas materialit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota për, asnjë votë kundër, dhe 14 vota të përmbajtura, miratohet Programi trevjeçar i banimit 2019/2021 në Komunën e Podujevës, duke përfshirë edhe raportin nga diskutimi/debati publik me qytetarë.

z.Agim Behluli, theksoi, edhe pse kjo pikë u përfundua, dëshiroj të ndërlihem me këtë temë dhe të japë disa sqarime. Unë jam kryetar i Komisionit, në këtë mandat, për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve dhe jam në dijeni se punimet kanë filluar për ndërtimin edhe të 20 shtëpive, edhe pse paksa me vonesë ngase janë paraqitur disa telashe për shkak se është dashtë që 7 kontejnerët e shitur të çmontohen dhe si rrjedhojë ka pas vonesa në lirin e hapësirave. Pastaj ka pas probleme dhe telashe edhe sa i përket zhvendosjes së atyre familjeve nga një kontejner në tjetrin me qëllim të lirimit të hapësirës për ndërtimin shtëpive. Pastaj janë 4-5 familje të cilat nuk kanë dokumentacion në bazë të të cilit banojnë në atë Lagje, pra janë pa vendime në ata kontejner. Andaj bëjë lutje të mos dalin pengesa nga ky Kuvend sa i përket qirasë sepse sigurisht do të jetë simbolike duke marrë për bazë gjendjen e atyre banorëve që jetojnë në atë Lagje. Madje shumë më mirë do të ishte të

themelohej një komision dhe të bënë verifikimin e të gjithë atyre që kanë përfituar shtëpi në atë lagje, se a qëndrojnë nëpër ato shtëpi apo jo, nëse po në rregull, nëse jo të shikojmë ku gjenden. Si Komision deri tani jemi munduar të bëjmë punën tonë në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe shpresoj se do të vazhdojmë edhe në të ardhmen.

5. Të ndryshme

z.Fatmir Rudari, theksoi, neve Grupit të këshilltarëve të PDK-së na është dërguar një kërkesë prej 35 studentëve të Komunës së Podujevës, kërkesë e cila besoj se ju është dërguar edhe Grupeve tjera të Kuvendit sepse ashtu më treguan studentët.

Kërkesa është bërë zyrtarisht (me nënshkrime, me nr. të ID-së) në adresë të Kuvendit të Komunës edhe pse nuk di sa mundemi ne si Kuvend t'iu bëjmë zgjidhje në këtë aspekt, konkretisht kanë kërkuar një sallë leximi për studentët. Duke pasë për bazë edhe aftin e provimeve që e kanë tash së shpejti që është muaji shtator, do të kërkoja edhe prej Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit apo edhe kompetenteve tjerë që në kuadër të mundësive t'iu bëhet një zgjidhje, sepse ne si Kuvend nuk e besoj se do të mund t'iu bëjmë zgjidhje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë që parafolësi e paraqiti, besoj se Drejtoritë përkatëse do ta kenë parasysh këtë kërkesë.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që në Komitetit për Komunitete të zëvendësohen dy anëtarë, përkatësisht njëri i cili mungon që një kohë dhe tjetri që është nga komuniteti serb i cili nuk ka qenë i pranishëm në Komitet që më shumë se 8 mbledhje.

Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, jua rikujtoj këshilltarëve të Kuvendit që muaji gusht është i paraparë të jetë pushim për Kuvendin e Komunës, përveç nëse eventualisht paraqitet nevoja për ndonjë seancë të jashtëzakonshme apo urgjente.

Me këtë e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje, duke ju dëshiruar pushim të këndshëm.

Mbledhja përfundoi në ora 11:25

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0060744/19
Podujevë,
29 korrik 2019

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi